

FTESË

Marrëdhëniet Shqipëri dhe Greqi – Çfarë mendojnë qytetarët

E martë, 29 Qershor 2021 @ ZOOM

Ora 15.00-16.30 (Tirana CEST TIME)

Ora 16.00-17.30 (Athina EEST TIME)

Registrohuni për këtë aktivitet duke klikuar [këtu](#)

[Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë](#) (OSFA) dhe [Fondacioni Helen për Evropën dhe Politikën e Jashtme](#) (ELIAMEP) kanë kënaqësinë t'ju ftojnë në aktivitetin e prezantimit të Raportit të Sondazhit Shqipëri – Greqi, Perceptimet e qytetarëve mbi bashkëpunimin midis dy vendeve. Aktiviteti do të organizohet **të Martën, 29 Qershor 2021 @ ZOOM**.

Marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Greqisë mbeten një enigmë e ndërlikuar. Të dy vendet fqinje kanë lidhje të gjera historike, ekonomike dhe sociale. Ato marrin pjesë në të njëjtën sferë gjeopolitike dhe kryesisht bien dakord për agjendën e zgjeruar për rajonin, duke u përqendruar në demokratizimin, zhvillimin ekonomik dhe forcimin e sundimit të ligjit, me synimin themelor të integritetit të Ballkanit në Bashkimin Evropian.

Me bashkëpunimin e intensifikuar midis dy vendeve në fillimin e viteve '90, dukshmëria ndaj njëri-tjetrit gjithashtu u rrit, duke sjellë në plan të parë frikërat dhe stereotipat e vjetra, si dhe burime të reja mosmarrëveshjesh. Si rezultat, Shqipëria dhe Greqia gjenden në një situatë paradoksale: të dy shoqëritë dhe ekonomitë janë shumë të ndërlidhura, por marrëdhëniet diplomatike dhe politike mbeten në provë dhe në një gjendje paqëndrueshmërie gati të përherëshme. Kombinuar me retorikën armiqësore të shprehur herë pas here në mediat sociale, ekziston rreziku që identitetet e të dy vendeve të zhvillohen në kundërshtim me njëri-tjetrin. Në këtë mënyrë, për të kuptuar se çfarë i shtyn këto keqkuptime, OSFA dhe ELIAMEP kryen një studim të përbashkët mbi perceptimet dhe qëndrimet që kanë qytetarët shqiptarë dhe grekë ndaj njëri-tjetrit. Projekti i përbashkët kërkimor, përfshiu dy sondazhe opinioni paralele të përbashkëta të kryera në Shqipëri dhe Greqi dhe zbatuar nga [Instituti Kërkimor Data Centrum](#) me qendër në Tiranë dhe [Njësia e Kërkimit të Opinioneve Publikë](#) e Universitetit të Maqedonisë me qendër në Selanik. Më shumë informacion mbi studimin mund të gjendet duke klikuar [këtu](#).

Ky aktivitet do të shërbejë për të diskutuar gjetjet e studimit dhe implikimet e tyre, veçanërisht me perspektivën e rritjes së nivelit të besimit midis dy shoqërive dhe forcimin e bazës së një partneriteti të ardhshëm. Sesioni i parë do të kushtohet fjalëve përshëndetëse dhe prezantimit të gjetjeve kryesore më të rëndësishme nga përfaqësuesit e ELIAMEP, OSFA, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë dhe Ambasadës së Greqisë. Në sesionin e dytë, një panel ekspertësh do të diskutojë në detaje rezultatet e studimit dhe sesi këto perceptime dhe qëndrime formësojnë marrëdhëniet dypalëshe dhe ligjërimin e politikës së brendshme në secilin vend. Për më tepër, panelistët do të eksplorojnë implikimet e qëndrimeve greke mbi procesin e zgjerimit të BE, jo vetëm mbi Shqipërinë, por mbi gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Marrëdhëniet Shqipëri dhe Greqi – Çfarë mendojnë qytetarët

Axhenda

E martë, 29 Qershor 2021 @ ZOOM

Ora 15.00-16.30 (Tirana CEST TIME)

Ora 16.00-17.30 (Athina EEST TIME)

Regjistrohuni për këtë aktivitet duke klikuar [këtu](#)

Seanca e hapjes: Fjalët përshëndetëse	
15.00-15.30	<ol style="list-style-type: none">1. Z. Andi Dobrushi, Koordinator Rajonal për Fondacionet e Ballkanit Perëndimor dhe Drejtor Ekzekutiv për Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA)2. Profesor George Pagoulatos, Drejtor i Përgjithshëm, Fondacioni Helen për Evropën dhe Politikën e Jashtme (ELIAMEP)3. Z. Maklen Misha, Këshilltar, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë4. Z. Alexandros Bouzis, Shefi i Zyrës të Diplomacisë Publike, Ambasada e Greqisë
Seanca e Dytë Prezantimi i gjetjeve nga Shqipëria dhe Greqia	
15.30-16:10	<ol style="list-style-type: none">1. Znj. Alketa Berzani, ish-Drejtor Ekzekutiv, Instituti Kërkimor Data Centrum – prezantimi i gjetjeve nga Shqipëria2. Z. Ioannis Armakolas, Studiues kërkimor i nivelit të lartë, Drejtues i Programit të Evropës Juglindore në ELIAMEP – prezantimi i gjetjeve nga Greqia3. Z. Blendi Kajsu, Asistent Profesor në Universitetin e Antioquia, Kolumbi4. Z. Angelos Athanasopoulos, Kryeredaktor mbi politikën, gazeta To Vima
16:10-16:30	<p>Seanca e pyetjeve dhe përgjigjeve</p> <p>Moderator: Znj. Alexandra Voudouri, Korrespondente e çështjeve diplomatike në Athina 9,84fm; Redaktore në MacroPolis</p>